

TEMA: PROÇESI I TRANSTEKSTUALITETIT NË ROMANIN POSTMODERN TË R. QOSES: “NJË DASHURI DHE SHTATË FAJE”

ESMERALDA HIDRI

AKTET VI, 3: 302-306, 2013

Pjesa më e madhe e prozës kosovare të gjysmës së II-të të shekullit XX, do të shoqërohej nga një dëshirë e dukshme novatorizmi. Vepra të tilla si novela “Përralla mbi lumturinë e Princit” e Nazmi Rrahmanit, e cila ndërton paralele të qarta me “Sidhartën” e Hesses; “Vdekja më vjen prej syve të tillë” e R. Qoses; rrëfimtaret e shumtë tek tregimi i gjatë “Udhëtimi i një pikë-uji” e Zejnula Rrahmanit, janë prova të një narratologjije të avancuar e që i kërkon me vetëdije format e reja të shprehshmërisë letrare.

Një pjesë e mirë e tyre sillnin dukurinë postmoderniste, në të njëjtën kohë kur ky fenomen letrar ishte shfaqur në letërsinë botërore.⁵⁹

Herë përmes kodeve metaforike tek Z. Rrahmani, tekstit të hapur tek S. Hamiti, rrjetës retorike të Anton Pashkut, apo alegorisë si figurë tipike të impersonales tek Rexhep Qosja, këto elementë të fuqishëm të një narratologjije të re do të shfaqen gati gjithmonë në vepra të cilat do të bëjnë objekt të vazhdueshëm qenësinë shqiptaro/kosovare. Dhe kjo do të jetë një dëshmi e parë e përkatësisë së tyre *post; përtej*, jo vetëm kohës që po jetonin si komb e individë, në kërkim të një të nesërme ndryshe, por dhe

përtej gjithçkaje që i kushtëzonte në jetën e në artin e tyre.

Që këtu interesi fillestar për romanin e Qoses “*Një dashuri e shtatë faje*”. Konceptuar nga autori si një vazhdim kronologjik i veprës “*Vdekja më vjen prej syve të tillë*”, romani do të paraqesë fatin e individit e më tepër intelektualit shqiptar, në historinë e Kosovës përgjatë dekadave të fundit të shekullit XX-të.

Shpejt ai do të përcaktohet si një roman polifonik, dëshmi e romanit modern dhe posmodern, në të cilin tejkalohet përfundimisht kronologjia rrëfimtare realiste.

Ajo që do të përpiqemi të ndërtojmë përgjatë këtij studimi, ka të bëjë me mënyrën sesi kjo vepër komunikon me të tjera vepra postmoderne apo jo, e më gjërësisht për ta paraqitur atë si një dëshmi të rrjetës së komunikimit mes tyre. Këndvështrimi letrar që i sheh veprat si invariante, e ka bazën tek mendimi letrar që nisi me Gëtën i cili pohoi se “*Vetëm budallenjtë mendojnë se janë origjinalë në të gjitha pikëpamjet, se janë plotësisht origjinalë*”. Do të jetë Eko ai që do të letrarizojë idenë përmes gojës së personazhit të tij rrëfimtari tek “*Il nome della rosa*”, frat Guglielmos, i cili thotë se “*Tani e kuptoj se jo rradhë librat flasim për libra, është njësoj sikur të flisnin mes tyre*.”⁶⁰

Sikurse ndodh shpesh, mendimi postmodern në këtë roman, është gërshtuar me

⁵⁹ Shiko Floresha Dado, “Tipare moderniste apo postmoderniste në prozën e Rexhep Qosjes”, *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qoses*, botim Instituti Albanologjisë i Prishtinës, Prishtinë, 2007, fq.127

⁶⁰ U Eko, *Il nome della rosa*, Bompiani, Milano, 2002, fq.289

idealet autoriale. Janë ato që në këtë rast kushtëzohen pikërisht nga kushtet e veçanta historike e politike të shoqërisë kosovare të kohës, duke shënjuar përfundimisht vetë autorin, krijimtarinë e tij dhe në mënyrë të veçantë këtë vepër.

Që në fillim ndjesia e një paraleleje të lexuar më parë, vjen e fortë duke sendërtuar faqe pas faqeje idenë se dhe një tjetër roman i letrave shqipe manifestohet si një invariant i romanit të Ekos.⁶¹

Pa dyshuar aspak me takimin e Qoses me krijimtarinë e mirënjohur të Ekos, (një nga eksponentët italianë më të rëndësishëm të postmodernës, cilësuar prej vetë Qoses si një nga katër shkrimtarët më të mëdhenj të gjallë të letërsisë evropiane sot), ndaj dhe për pëlqimin e madh që romani në fjalë, duhet të ketë ngjallur tek ai⁶², do të përpiqemi të vëmë në dukje sesi ai ka mundur t'i shpëtojë një frike të madhe për çdo krijues, frikës së ndikimit nga një tjetër krijues⁶³.

Që të dy romanet nisin me pretendimin e dorëshkrimit, ku herë një botues si Arben Begeja e herë zëri i një sjellësi që vjen si i tretë në një dorëshkrim nga Dom Adson de Melk⁶⁴, krijojnë iluzionin e të gjendurit jashtë kësaj vepre. Vjen kështu sygjërimi i të qënit thjesht referues të një dorëshkrimi, i pari i Çerem Çaparit, një vajazanas pa ambicje shkrimtari, e në rastin e “*Emrit të*

trëndafililit”, të një murgu të shek XIV, gjetur në manastirin e Melkut nga abati Vallet e që përfundon në 1968 në duart e sjellësit tonë, lexues sikurse ne dhe ruajtës i tekstit.

Por Eko nuk e ruan gjer në fund këtë iluzion. Në pasthënjen që do të shoqërojë ribotimet e romanit, ai do të tregojë përzgjedhjen për të pasur një rrëfimitar larg tij, të cilin do ta cilësojë si maskë, duke rrëfyer që në këtë mënyrë do të ishte i lirë, sepse maska do të fliste për të. Nga ana e tij, Rexhep Qosja nuk prononcohet aspak në lidhje me këtë zgjedhje letrare. Kjo për të larguar nga vetvetja ndoshta një alter-ego të tij, apo më thjeshtë pasi si pjesë e një triologjie, fabula është ende e pakryer gjer në fund, dhe e fshehta do të mund të zbulohet vetëm në momentin kur vepra trepjesëshe të përmbushë tërësinë e saj.

Prania e metanarrativës së synuar, përcaktuar nga studiuesit e romanit të Ekos si një nga elementët më të rëndësishëm të narratologjisë postmoderne, shikohet nga vetë autori, më tepër si një lloj “*dialogjizmi artificial*”. Më konkretisht për të, është si vënia në skenë e një dorëshkrimi tek i cili zëri rrëfimitar reflekton e tenton të dëshifrojë e gjykojë në të njëjtin moment në të cilin tregon.⁶⁵

Kjo i mundëson të dy krijuesve tanë lirinë, një liri që nuk mund të jetë e plotë pasi, siç vë re edhe Eko, do të mund të ishte “*i lirë nga dyshimet por jo nga jehona e intertekstualitetit. Zbulova kështu, shkruan ai, atë që shkrimtarët e kanë ditur gjithmonë (e që shpesh na kanë thënë): Librat flasin gjithmonë për libra të tjerë dhe çdo histori tregon një histori të rrëfyer më parë. E dinte Homeri, Aristoteli ...Ndaj historia ime nuk mund të niste vetëm me një dorëshkrim, e edhe ajo do të ishte citim natyrisht.*”⁶⁶

Përdorur si term së pari nga Julia Kristeva⁶⁷, intertekstualiteti presupozon marrëdhënien që

⁶¹ Ky roman bashkë me romanin e Vath Koreshit, “Ulku dhe Uilli” janë marrë si shembull invariantesh të romanit të U. Ekos

⁶² Cituar pjesë nga intervista e Qoses ku shkrimtari italian Eko përcaktohet nga autori si një prej katër shkrimtarëve më të mëdhenj, të gjallë, të Evropës sot, bashkë me Hose Saramago, Gynter Gras e Salman Ruzhdi.

⁶³ Vetë Eko dëshmon frikën e ndikimit nga një tjetër gjigand i risive, Borges, në pjesën “Borges e la mia angoscia dell’ influenza”, Sulla letteratura, fq.128 ku dhe nis me postulatën e famshëm të postmodernizmit “*Një tekst i shkruar është një dorëshkrim besuar shisheje*”

⁶⁴ *Ulku dhe Uilli*, fq.48

⁶⁵ Shiko Eco, Sulla letteratura, Saggi Bompiani, 2002, fq.228

⁶⁶ U.Eko, “Postile”, *Il nome della rosa*, Bompiani, 2002, fq.512-513

⁶⁷ Julia Kristeva, *Sèmeiotike Recherche pour une sémalyse*, Seuil, Paris, 1969

vendos ndërteksti (interteksti⁶⁸) në tekstin në të cilin është rikontekstualizuar, duke fituar statusin e një teksti origjinal. Ndryshe Eko e quan në rastin e romanit të tij *"ironi intertekstuale"*. Pra kemi një dorëshkrim, citim i plotë i një manastiri të shek XIV, por paraqitur si një version i '800-ës, ku ironia intertekstuale dëshkohet që në titullin e faqes *"Natyrisht një dorëshkrim"* me gjithë shtresën ironike që termi *"natyrisht"* mbart.

Edhe në romanin e Qoses jehona e intertekstualitetit dhe hipertekstualitetit, është njësoj e pranishme që në nisje. Një botues rrëfen për një dorëshkrim e për disa shënime plotësuese të Çerem Çaparit, ndërsa nënvizon se atij si botues i takon veç merita a faji pse e boton: *"merita në sytë e atyre që edhe në letërsi e duan të vërtetën për kohën dhe për njerëzit në një kohë të pakohë, ose faji në sytë e atyre që, si thuhet, ndyrësitë do të donin t'i mbulonin me heshtje."*⁶⁹

Do të jetë personazhi që pushton vëmendjen e lexuesit, endacaku-profet Mihran Kumani, ai që do të përmbushë më së shumti këtë element postmodern. Ai prezantohet në familjen e Din Çaparit ku e bujtin, përmes një letre-tregim, të cilën kërkon ta lexojë pikërisht rrëfimtari, atëherë fëmijë. Ky profet që ruan në një strajcë leshi një libër pa kapak, që mund të ishte *Kur`ani, Bibla, Libri tibetan i të vdekurve, Libri i këshillave i majëve* apo edhe ndonjë libër mitologjik, të sjell ndër mend murgun plak e të verbër, në bibliotekën e manastirit tek *"Il nome della rosa"*, ndërsa ky i fundit të sjell para syve vetë Borgesin e mbyllur në labirinthin e pashtershëm të bibliotekës mitike, aty ku të gjitha librat janë një libër i vetëm e ku çdo libër është të gjithë librat.

Citime nga Poe, përmes vargut të pavdekshëm të këtij të fundit: *Kurrë më*, i cili në tekst shfaqet tre herë si për të kujtuar pamundësinë e përhershmerisë, vijnë në gojën e Mihran Kumani sikurse edhe vajtimi popullor në faqen 38 *"Ore vlla, i dashmi vlla,/t'i shoh plumat kah t'kanë ra..."*. Pasazhet e shpeshta të kuranit, haditheve e fjalëve të urta, si *"i kam mësuar shumë dije që*

nuk mund të mësohen pa vuajtur" vijnë bashkë me pjesë si kjo që po citojmë, të cilat sjellin biblën e kuranin në të njëjtën kohë: *"...deri në këtë moshë në të cilën jam, vëlla nuk më është bërë kush edhe pse vëlla kam kërkuar me pishë në dorë nëpër tokë e nëpër qjell; urimin më të përzemërt nuk ma ka bërë ai që këndon, por ai që vajton; të mirën më të dëshiruar nuk ma ka bërë ai të cilit i kam bërë mirë, por ai të cilit nuk i kam bërë as mirë, as keq; fjalën e dhënë nuk ma ka mbajtur ai në të cilin kam shpresuar, por ai prej të cilit nuk e kam pritur...rrugën e drejtë nuk ma ka treguar ai që rrugën e ka gjetur, por ai që rrugën e ka humbur; syrin më së thelli nuk ma ka nxjerrë më i largëti, por më i afërmi."*⁷⁰. Këto intertekste lidhen mes tyre në tekstin që i bashkon e në personazhin, Mihran Kumani, që i mbart, për të krijuar një tjetër status kuptimor. Kjo, pa u larguar nga nocioni invariant, të cilin një tekst postmodern e kërkon si pjesë të tijën. Pasi gjithçka që tek ne vjen si reminishencë, imitim, koment apo dhe në formën e plagjiatit, pra gjithçka që krijon tek ne ndjesinë që na shkakton ajo që na duket sikur e kemi lexuar, do të njihet pikërisht si përmbushje e nocionit *"invariant"*. Citimi si forma më e evidente e dialogjizmit, ose siç e përdor L.Hutcheon *"ekoja tekstuale"*, nuk i tremb më krijuesit e ndërgegjegjshëm për faktin që një tekst i shkruar është një dorëshkrim besuar një shisheje. Prania e tyre e shpeshtë përgjatë gjithë romanit të Qoses, i ngre ato në nivelin bashkues si *hipertekste*, pra një shkallë më lart në procesin e *transtekstualitetit*, duke realizuar përgjithsisht *hipertekste* të cilat imitojnë tipin gjenerik.⁷¹

⁷⁰ R. Qosja, *Një dashuri dhe shtatë faje, Toena*, fq.43

⁷¹ Transtekstualiteti nënvizon planet e dialogimit ndërmjet teksteve në funksion të një teksti final, të kalimit të teksteve në tekst.

Hipertekstualiteti ose mbitekstualitet, quhet procesi që zhvillohet ndërmjet hipotekstit (tekstit origjinal) dhe hipertekstit (mbitekstit). Genette e cilëson si relacion bashkues i një teksti B (hipertekst), me një tekst të mëparshëm A (hipoteksti), mbi të cilin ngrihet pa u bërë asnjëherë koment i tij. Ai ndan ato në hipertekste që mbartin direkt hipotekstin origjinal dhe hipertekste që imitojnë tipin gjenerik ku futet "romani enciklopedik" që nga Dante deri tek Pynchon.

⁶⁸ Interteksti: prani e një teksti brënda një tjetri; shiko Zherar Zhenet, *Figura, Rilindja*, Prishtinë, 1985, fq.185

⁶⁹ R. Qosja, *Një dashuri dhe shtatë faje, Toena*, Tiranë, 2003, fq.11

Në këtë mënyrë ajo që përftohet është një roman i mbushur me dije dhe ndërgjegjësi. Në të, e shkuara i kujton të tashmes atë që i ka ndodhur e që mund t'i ndodhë sërisht në të ardhmen, duke përfutur një tjetër kohë të pakohë, e njohur në postmodernizëm si e *tashmja eterne*.

Paraqitja përmes titujve prezantues dhe natyra e butë, por këmbëngulëse e zërit rrëfimitar, përveçse bëjnë lidhjen me veprën pararendëse "Vdekja më vjen prej syve të tillë", por të risjellin ndër mënd përjetimin e veçantë të "Odin Mondvalsenit" të Kasem Trebeshinës. Do të jëtë kjo vepër që nga ana e saj do të rikthejë sërisht ngjyrimin e titujve të romanit të Ekos, me natyrën e tyre prezantuese, të thjeshta por drithëruese në të njëjtën kohë: "Secondo giorno. Mattutino. Dove poche ore di mistica felicità sono interrote da un sanguinosissimo evento."⁷² (Dita e dytë. Mëngjes herët. Ku pak orë lumturije mistike ndërpriten nga një zhvillim i përgjakshëm)

Ja sesi zinxhiri i librave të lexuar, formësohet i plotë, nga leximi rishtaz i një libri të vetëm.

Nuk mund të lë pa përmendur, ndonëse shkurtimisht, sesi mënyra e veçantë e të rrëfyerit të ngjarjeve të vërteta që duken si të sajura dhe atyre të sajura që duken si të vërteta, e sjell romanin e Qoses në rezonancë me një tjetër kolos të letrave postmoderne. Pynchon, cilësuar si iniciator i postmodernës, i asaj periudhe, termi emërtues i së cilës në atë kohë as që ekzistonte² (ose të paktën jo në kuptimin që mbart sot) dialogon edhe përmes veprave të shkruara jo prej tij.

Që të dy shkrytarët në fjalë, duket që kanë për zemër historitë e harruara apo të parrëfyera, kanë refuzuar dukshëm kulturën e masave ku adhurohet gjithmonë fitimtari apo njeriu pa të

meta, për t'ju dedikuar rrëfimeve të çensuruara, të fshira apo të zhytura në histori.

Ndërsa lexuesi i romanit të parë të Pynchon, shkruar në 1963, lexon historinë e panjohur të Hereros, popull afrikan që iu nënshtrua një luftë të pamëshirshme zhdukjesh në 1904 në Namibia nga ushtria imperiale gjermane, mund t'i duket ajo krejtësisht e sajuar nga autori. Në të vërtetë kjo masakër e harruar ka ndodhur realisht, dhe autori ishte bazuar në dokumente historike rreth saj. Por mënyra e veçantë dhe fantazioze e rindërtimit të ngjarjes, shoqëruar dhe me vizionin i krijues autorial, bashkë me një pjesmarrje të dukshme emotive, do ta bëjë të vërtetën të mjergullt, por jo të ndryshueshme⁷³

E njëjta paraqitje kaotike e të vërtetës historike, ku nuk ndan dot të magjishmen, apo sajësën, nga fakti, vëmë re dhe në romanin e Qoses. Duke përzier pa paralajmërim të vërtetën me të sajuarën, por në një mënyrë të tillë që lexuesi i kujdesshëm të mund të rindërtojë ngjarjen edhe duke u dokumentuar jashtë romanit, të dy krijuesit duket se duan t'i kujtojnë vazhdimisht lexuesve të tyre se po lexojnë një roman e jo një libër historik. Por insistojnë në të njëjtën kohë, që ato të mos harrojnë se asnjëherë nuk janë larguar nga faktet historike për të ndërtuar botët e tyre, në të cilat është ruajtur e gjallë memoria e asaj që ka ndodhur.

Që këtu zë jetë dhe teoria e pasqyrave të përthyerë, që të kujtojnë vazhdimisht që bëhet fjalë për pasqyra e jo botë reale, por pasqyra që mbajnë gjallë pikërisht botët e tilla.

Kujtojmë që replika më e madhe e Thomas Pynchon në romanin e tij "Mason&Dixon" ishte ajo që vinte në dukje se nuk ka asgjë më për të pasur frikë, sesa një version unik sesi janë gjërat në botë apo sesi kanë shkuar sipas historisë. Përkundër "mendimit unik", letërsia e praktikuar prej tij e më gjërë, prej Ekos, Qoses, Tufës, Koreshit etj, ajo postmoderne, kërkon t'i japë zë shumë versioneve të historisë, edhe atyre të heshtura, që të krijohet në këtë mënyrë

Shiko Gerard Genette, *Palimpsestes-La litterature au second degre*, Seuil, Paris, 2000, fq.10-13

⁷² U. Eko, *Il nome della rosa*, Bompiani, 2002, fq.109

² shiko Umberto Eco, "Postile", *Il nome della Rosa*: "[...]mos harrohet se sot Pynchon citohet mes iniciatorëve të postmodernizmit, por atëherë kjo fjalë nuk ekzistonte, të paktën në Itali, dhe po niste të përdorej nga John Barth në Amerikë.", **Bompiani**-Novembre 2002, fq.527.

⁷³ Kjo ngjarje është bërë së fundi dhe shkak i një diskutimi internacional, pasi pasardhësit e fisit Herero, të shpëtuar nga kampet gjermane të zhdukjes, i kanë kërkuar dëmshpërblim Gjermanisë.

mundësia e dialogut, e diskutimit. Vetëm kështu mund t'i jepet hapësirë edhe të vërtetës së të dobëve, të shfrytëzuarve apo të mundurve.

Bibliografi

Agnes Heller, A., Feher, F., (1992), *La condizione politica postmoderna*, Marietti, Genova.

Deleuze, G., (1997) *Differenza e Ripetizione*, Faffaello Cortina Editore, Milano.

Genette, G., (2000), *Palimpsestes-La litterature au second degre*, Seuil, Paris.

Genette, G., (1985), *Figura*, Rilindja, Prishtinë.

Kristeva, J., (1969), *Recherche pour une semanalyse*, Seuil, Paris.

Dado, F., (2007), *Krijimtaria shkencore e letrare e R. Qoses*, Instituti Albanologjise I Prishtinës, Prishtinë.

Eco, U., (2002), *Sulla letteratura*, Saggi Bompiani.

Eco, U., (2002), *Postile, Il nome della rosa*, Bompiani.

Gambaro, F., (1996), *Invito a conoscere la neoavanguardia*, Mursia Editore, Milano..